

UDHËZIM
Nr.4, datë 19.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”,

UDHËZOJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1.a)Për bingo, për rrethet e kategorisë së parë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

-Për rrethet e kategorisë së dytë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

-Për rrethet e aktegorisë së tretë, fondi ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milionë) lekë.

-Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milionë) lekë.

2.Për bastet sportive dhe baste për gara në pistë:

a) Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

3.Për lotarinë kombëtare dhe për kazinotë:

a)Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masëm 20 000 000 (njëzet milionë lekë).

4.Për kazinotë elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

5.NJMLF-ja i propozon Ministrit të Financave zhbllokimin e këtij fondi, me kërkesë të organizatorit të lojërave, në rast se vërtetohet se ky i fundit nuk ka detyrime tatimore, nuk ka gjoba të pashlyera, si dhe kur mbyll veprimtarinë e tij, të vërtetuara këto nga organet shetërore përkatëse.

6.Ngurtësimi duhet të jetë në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar.

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin e Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode